

**Devoll Hydropower Sh.A.
Raporti i Audituesve të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja

	Page
Raporti i audituesve të pavarur	i
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e rrjedhës së mjeteve monetare	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 - 33

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Devoll Hydropower sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Devoll Hydropower sh.a., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Elbasanit, Pallati Postal, Fakulteti
Gjeologji - Miniera,
Tirana, Albania
Numri i identifikimit i personit të natyreshëm
(NUIS): L41709002H



Elvis Ziu

Partner Angazhimi
Elvis Ziu

19 Prill 2018
Tiranë, Shqipëri


Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017


(Të gjitha vlerat janë në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Aktivët			
Prona, makineri dhe pajisje	8	49,076,931,164	39,046,551,593
Aktive jo-materiale	9	44,162,559	17,618,589
Parapagime	10	1,655,304,019	1,266,680,863
Totali i aktiveve afatgjata		50,776,397,742	40,330,851,045
Parapagime	10	468,477,436	561,951,055
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	11	575,482,731	502,933,303
Garanci bankare	12	13,600,000	10,000,000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13	3,286,987,308	6,931,646,780
Total i aktiveve afatshkurtra		4,344,547,475	8,006,531,138
Total i aktiveve		55,120,945,217	48,337,382,183
Kapitali			
Kapitali aksionar i paguar dhe nënshkruar	14	70,055,000,000	61,970,000,000
Primi i kapitalit aksionar	15	8,590,000	8,590,000
Humbja e akumuluar		(19,244,357,155)	(18,719,009,103)
Totali i kapitalit		50,819,232,845	43,259,580,897
Detyrimet			
Llogari të pagueshme	16	4,229,698,015	5,019,893,915
Të tjera të pagueshme	17	72,014,357	57,907,371
Totali i detyrimeve afatshkurtra		4,301,712,372	5,077,801,286
Totali i detyrimeve		4,301,712,372	5,077,801,286
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		55,120,945,217	48,337,382,183

Shënimet shpjeguese në faqet 5-33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 19 prill 2018 dhe janë nënshkruar për Devoll Hydropower Sh.A., nga:


 Tom Kristian Larsen
 Drejtori Ekzekutiv



Devoll Hydropower Sh.A.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat	18	2,016,269,040	778,634,862
Blerje energjie	19	(622,247,108)	(320,885,095)
Blerje kapacitetesh	20	(93,595,223)	(33,325,309)
Shërbime	21	(881,931,330)	(502,896,420)
Kosto personeli	22	(180,488,077)	(138,095,707)
Shpenzime zhvlerësimi i pronave, makinerive dhe pajisjeve	8	-	(15,986,173,311)
Amortizimi i prona, makineri dhe pajisje	8	(519,433,617)	(85,940,780)
Amortizimi i aktiveve jo materiale	9	(8,395,296)	(5,360,386)
Shpenzime të tjera	23	(96,132,307)	(133,065,559)
Humbja nga aktiviteti i shfrytëzimit		(385,953,918)	(16,427,107,705)
Shpenzimet financiare neto			
Humbja neto nga kursi i këmbimit	24	(139,351,944)	(168,745,429)
(Humbja)/e ardhura financiare, neto	25	(42,190)	1,663,614
		(139,394,134)	(167,081,815)
Humbja para tatimit		(525,348,052)	(16,594,189,520)
Tatimi mbi fitimin	26	-	-
Humbja e vitit		(525,348,052)	(16,594,189,520)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin		(525,348,052)	(16,594,189,520)

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha vlerat janë në Lek)

	Kapitali aksionar i paguar dhe i nënshkruar	Primi i kapitalit aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	45,420,000,000	8,190,000	(2,124,819,583)	43,303,370,417
<i>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Humbja e vitit	-	-	(16,594,189,520)	(16,594,189,520)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(16,594,189,520)	(16,594,189,520)
<i>Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital</i>				
Kontribute nga pronarët	16,550,000,000	400,000	-	16,550,400,000
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	16,550,000,000	400,000	-	16,550,400,000
Gjendja më 31 dhjetor 2016	61,970,000,000	8,590,000	(18,719,009,103)	43,259,580,897
<i>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Humbja e vitit	-	-	(525,348,052)	(525,348,052)
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(525,348,052)	(525,348,052)
<i>Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital</i>				
Kontribute nga pronarët	8,085,000,000	-	-	8,085,000,000
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	8,085,000,000	-	-	8,085,000,000
Gjendja më 31 dhjetor 2017	70,055,000,000	8,590,000	(19,244,357,155)	50,819,232,845

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.**Pasqyra e rrjedhës së mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Lek)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Aktivitetet e shfrytëzimit		
Humbja e vitit	(525,348,052)	(16,594,189,520)
<i>Rregullime për:</i>		
Humbja nga zhvlerësimi	8	15,986,173,311
Amortizimi për prona, makineri dhe pajisje	8	85,940,780
Amortizimi për aktive jo materiale	9	5,360,386
Humbje të porealizuara nga mjetet monetare të mbajtura në monedhë të huaj		101,612,964
Të ardhura nga interesi	23	(1,666,440)
Shpenzime interesi	23	2,826
	59,158,704	(416,765,693)
<i>Ndryshime në:</i>		
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe tjera të arkëtueshme	11	(311,927,318)
Garancitë bankare	12	-
Llogaritë e pagueshme tregtare		29,021,828
Të tjera të pagueshme	17	42,751,108
	(368,372,636)	(656,920,075)
Interesa të arkëtuara	10,541	1,666,440
Interesa të paguara	(52,731)	(2,826)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet e shfrytëzimit	(368,414,826)	(655,256,461)
Aktivitetet investuese		
Blerja e pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe aktiveve jo materiale	(11,009,459,456)	(18,664,499,863)
Ndryshime në parapagime	10	1,293,833,350
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet investuese	(11,304,608,993)	(17,370,666,513)
Aktivitetet financuese		
Derdhje në kapital nga aksionarët	14	16,550,400,000
Flukset monetare nga aktivitetet financuese	8,085,000,000	16,550,400,000
Ndryshimi neto i mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre	(3,588,023,819)	(1,475,522,974)
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	6,931,646,780	8,508,782,718
Efekti i luhatjes së kursit të këmbimit në mjetet monetare të mbajtura në monedhë të huaj	(56,635,653)	(101,612,964)
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	3,286,987,308	6,931,646,780

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përves rasteve kur shprehet ndryshe)

1. Të përgjithshme

Informacion i përgjithshëm mbi Shoqërinë

Devoll Hydropower Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar në Shqipëri. Adresa e regjistruar e Shoqërisë është në Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra Nr.1204, Tiranë. Devoll Hydropower Sh.A. është regjistruar në datën 18 Dhjetor 2008 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NIPT K82418002C dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Shoqëria fillimisht është themeluar fillimisht si shoqëri koncesionare nga EVN AG dhe Statkraft AS dhe u përfshi në një marrëveshje koncesionare BOOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentraleve në lumin Devoll, me vendndodhje në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll, midis komunave Maliq dhe Banjë. Devoll Hydropower Sh.A bashkë me EVN AG dhe Statkraft AS u shpallën fitues të marrëveshjes koncesionare, bazuar në Ligjin nr. 10083 të datës 23 shkurt 2009.

Pas transferimit të aksioneve nga EVN AG dhe Statkraft A.S. gjatë viteve 2013 dhe 2014 Statkraft Markets B.V. është aksionari i vetëm i Devoll Hydropower Sh.A.

Drejtuesit e Shoqërisë

Bordi Drejtues:

Z. Tron Engebretsen, Kryetar

Znj. Tima Iyer Utne

Znj. Wenche Lund Oyno

Drejtori ekzekutiv është Z. Tom Kristian Larsen. Më 1 mars 2018 Tima Iyer Utne është zëvendësuar me Dag Hjort.

Marrëveshja Koncesionare - terma të rëndësishëm

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 9663 "Për koncesionet" i datës 18 dhjetor 2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463 "Mbi aprovimin e autoritetit kontraktues për dhënien e koncesionit për hidrocentralet në kaskadën e lumit Devoll dhe aprovimin e bonusit në procedurën për përzgjedhjen e ofertës së Shoqërisë" i datës 18.07.2007, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10083 "Mbi aprovimin e Marrëveshjes Koncesionare ndërmjet METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI) dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER SH.A., si Shoqëria koncesionare për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë" më datë 23.02.2009 ("Marrëveshja Koncesionare") e ndryshuar me Ligj nr. 10037 datë 21.10.2010 "Për një shtesë në Ligjin nr. 10083 datë 23.02.2009", me Ligj nr. 105/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10083 datë 23.02.2009" dhe me Ligj nr. 7/2015 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10083, datë 23.2.2009".

Sipas Marrëveshjes Koncesionare dhe ndryshimeve përkatëse, Shoqëria do të ndërtojë të paktën dy njësi prodhuese hidroenergjetike (Moglicë dhe Banja) me një kapacitet total rreth 256 MW dhe me një prodhim mesatar rreth 700 GWh në vit energji të ri-përtëritshme dhe të pastër.

Koncesioni për hidrocentralet përfshin planifikimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e të paktën dy hidrocentraleve të vendosura në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll. Në përputhje me koncesionin për hidrocentralin, trualli i ndërtimit, përdorimi i ujit të luginës së lumit Devoll ndërmjet lartësive 95-650 metra mbi nivelin e detit, përfshirë dhe Lumin Devoll dhe degëzimet e tij do të transferohen Devoll Hydropower Sh.A.

Sipas Marrëveshjes Koncesionare, koncesionari është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga Koncesionari). Marrëveshja Koncesionare është organizuar si një model projekti i tipit BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një Periudhë Fillestare prej 35 vjetësh nga data efektive. Nëse në përfundim të Periudhës Fillestare, as arritja e normës IRR dhe as Ngjarja e Arritjes së Prodhimit nuk kanë ndodhur, Faza Fillestare do të shtyhet automatikisht sipas dispozitave të Marrëveshjes Koncesionare ("Shtyrja e Afatit").

1. Të përgjithshme (vazhdim)

Marrëveshja Koncesionare – terma të rëndësishëm (vazhdim)

Pas kësaj periudhe, pronësia e hidrocentralit do t'i transferohet MEI (më parë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë – METE) pa asnjë tarifë, bashkë me pajisjet e operimit, të drejtat e garantuara dhe kontratat.

Njësia prodhuese hidroenergjetike Banja ("Banja HPP") filloi aktivitetin tregtar në shtator të vitit 2016. Aktiviteti tregtar i hidrocentralit Banja mbështetet nga licencat e mëposhtme të dhëna nga Enti Shqiptar Rregullator i Energjisë (ERE):

- Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike Nr. 342, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 80, i datës 9/6/2016 të ERE për një periudhë 30 vjeçare;
- Licenca për Tregtimin e Energjisë Elektrike Nr. 274, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 35, i datës 4/3/2015 të ERE për një periudhë 5 vjeçare;
- Licenca për Furnizimit e Energjisë Elektrike Nr. 343, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 81 i datës 9/6/2016 për një periudhë 5 vjeçare.

Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka operuar me licencën për prodhimin e energjisë elektrike dhe licencën për tregtimin e energjisë elektrike.

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi Drejtues më 19 prill 2018.

Detaje lidhur me politikat kontabël të Shoqërisë gjenden në shënimin 5.

3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

4. Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve

Për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare është kërkuar që drejtimi të bëjë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

(a) Gjykime

Informacioni lidhur me gjykimet që janë bërë në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë edhe efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i konsiderueshëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe përlllogaritje për të cilat përcaktimi i detyrimit përfundimtar është i pasigurt. Në rast se detyrimet tatimore përfundimtare të këtyre çështjeve janë ndryshe nga vlera me të cilën janë regjistruar në fillim, këto diferenca do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e tatim fitimit dhe tatimin e shtyrë aktiv e pasiv të periudhës në të cilën bëhet një përcaktim i tillë.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përves rasteve kur shprehet ndryshe)

4. Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(b) Supozime dhe pasiguritë në parashikime

Informacioni lidhur me pasiguritë në parashikime dhe vlerësime të cilat kanë edhe efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

(i) Jeta e dobishme e pronave, makinerive dhe pajisjeve

Siç është përshkruar në shënimin 5 (c) (iii), Drejtimi i Shoqërisë rishikon dhe vlerëson jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi i Shoqërisë ka vendosur që jeta e dobishme për prona, makineri dhe pajisje nuk ka ndryshuar.

(ii) TVSH e zbritshme

Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar zhvlerësimin e TVSH-së për t'u rimbursuar në fund të vitit dhe vlerësoi se do të arkëtohet plotësisht në vitet e ardhshme

(iii) Testi i zhvlerësimit

Supozimet kryesore që lidhen me vlerat e rikuperueshme paraqiten në Shënimin 8 (i).

5. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës së raportimit. Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Instrumentet financiare

Fillimisht, Shoqëria i njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në mjete monetare në datën e krijimit. Të gjitha aktivitet e tjera financiare janë njohur fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivitet financiar skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale të aktivitet financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar transferohen. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuar që është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria është njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivitet dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, detyrimet tregtare dhe nga llogaritë e pagueshme.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat me maturitet më pak se tre muaj.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e detyrimeve tregtare dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumente financiare jo derivativë janë të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si zë i kapitalit.

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Prona, makineri dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Prona, makineri dhe pajisje maten me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuar vetë përfshijë koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara (nëse ka). Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje kanë jetë-gjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme) të pronave, makinerive dhe pajisjeve. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të pronës, makinerisë dhe pajisjes dhe janë pasqyruar neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat dhe shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e pronave, makinerive dhe pajisjeve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen përgjatë afatit të qirasë. Aktivitetet në proces nuk amortizohen. Jetët e dobishme të vlerësuar për disa kategori të prona, makineri dhe pajisje për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

- Objektet e rregullimit të ujit 40-75 vite
- Turbinat, gjeneratorët 15-40 vite
- Ndërtesa, rrugë, ura dhe kalata 50-75 vite
- Objektet e rrjetit 50 vite
- Mjete, pajisje dhe mjete transporti
- Mjete të tjera dhe pajisje 10-40 vite

Jetët e dobishme të vlerësuar për kategoritë e mëposhtme të prona, makineri dhe pajisje reflektohen në mënyre të përafërt nga normat e amortizimit dhe metodat e paraqitura më poshtë për periudhën aktuale dhe atë krahasuese:

- Përmirësimet e ambienteve me qira Vlera e mbetur me 5%
- Mjete, pajisje dhe mjete transporti
- Pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike Vlera e mbetur me 20 - 25%
- Automjete Vlera e mbetur me 20%

Amortizimi i këtyre aktiveve do të fillojë kur ato të jenë të gatshme për përdorim, d.m.th. kur ato të jenë në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për tu përdorur në mënyrën e synuar nga drejtimi i Shoqërisë. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi dhe i nënshtrohen rregullimeve nëse është e nevojshme.

(d) Aktivitet jo materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet jo-materiale të cilat janë blerë nga Shoqëria janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përves rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Aktivet jo materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në një aktiv specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera duke përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markën, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e zërave të aktiveve jo materiale minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime.

Jeta e dobishme e vlerësuar reflektohet nga normat dhe metodat e mëposhtme të amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese:

- | | |
|--------------------------------|-----------------------|
| • Programe kompjuterike | Vlera e mbetur me 25% |
| • Aktive të tjera jo materiale | 6.67 vite |

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen çdo datë raportimi dhe rregullohen sipas rastit.

(e) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe ka patur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar dhe këto efekte maten në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet uljes së skontimit. Kur një ngjarje e ardhshme (pagesa nga një debitor) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në pasqyrën e fitimit apo humbjes.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlerat kontabël (neto) të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivet grupohen në grupe të vogla aktivesh të cilat gjenerojnë flukse hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera apo njësive gjeneruese të parasë.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese të parasë është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim bazohet në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare të skontuara në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të parasë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera kontabël e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë është më e lartë se vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm në masën sa vlera kontabël e aktivit nuk e tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike si dhe gjithashtu në kryerjen e shërbimeve të lidhura me to.

(i) Tregtimi i energjisë elektrike

Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar, neto nga kthimet

Për shitjen e energjisë, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë hidhet në rrjet dhe matet në pikën e shpërndarjes. Të ardhurat nga shitja ndërkufitare e energjisë elektrike nëpërmjet territorit shqiptar (Rrjeti Shqiptar i Transmetimit) njihet bazuar në skedat orare të konfirmuara nga palët.

(ii) Kryerja e shërbimeve

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përputhje me fazën e kompletimit për kryerjen e punimeve në datën e raportimit. Faza e kompletimit vlerësohet në bazë të inspektimeve të punës së kryer.

(g) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan kontributi i përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

(h) Provigjionet

Një provigjion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lind një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të parashikohet me siguri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet janë përcaktuar duke aktualizuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

(i) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Lehtësirat e përfituara për qiratë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet dhe humbjet nga konvertimi janë paraqitur neto.

(k) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përves rasteve kur shprehet ndryshe)

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Interesat dhe gjobat e lidhura me tatimin mbi fitimin, përfshirë trajtimet tatimore të paqarta, trajtohen sipas IAS 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi mbi fitimin i periudhës

Tatimi i periudhës përfshin tatimin e pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar apo arkëtuar në lidhje me vitet e kaluara. Shuma e tatimit të periudhës e pagueshme apo e arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar i cili reflekton pasiguritë e lidhura me tatimin mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo llogaritet duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Aktiviteti dhe detyrimi tatimor i periudhës kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

(ii) Tatimi mbi fitimin i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Një aktive për tatime të shtyra njihet për humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është i mundur realizimi i të ardhurave të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Përfitimet e ardhshme tatimore përcaktohen duke u bazuar në rimarrjen e diferencave të përkohshme të zbritshme. Nëse shumën e diferencave të përkohshme të zbritshme nuk është e mjaftueshme për të njohur një aktivitet tatimor të shtyrë, përfitimet tatimore të ardhshme të rregulluara për rimarrjen e diferencave ekzistuese të përkohshme, do konsiderohen bazuar në planin e biznesit. Aktiviteti tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa të mos jetë më e mundur të realizohen përfitimet tatimore të lidhura me to; zvogëlimet të tilla rimerren në momentin që rritet probabiliteti i fitimeve të ardhshme tatimore.

Aktiviteti për tatime të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është e mundur që të ketë fitime të ardhshme tatimore kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të rimerren, duke përdorur normat tatimore që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit

Matja e tatimit të shtyrë reflekton efektet tatimore që do të lindnin nga mënyra se si Shoqëria pret që në fund të periudhës raportuese, të realizojë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Aktiviteti dhe detyrimet për tatime të shtyra kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

6. Standarde të reja të cilat nuk kanë hyrë në fuqi

Një sërë standardesh të reja, amendime apo interpretime të tyre janë bërë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2017 dhe aplikimi i hershëm i tyre është i lejuar; megjithatë Shoqëria nuk i ka aplikuar më herët standardet e reja dhe amendimet e mëposhtme në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që janë më të rëndësishme për Shoqërinë janë paraqitur më poshtë:

A. Efekti i vlerësuar i adoptimit të SNRF 15 dhe SNRF 9

Shoqëria gjeneron të ardhura nga kontratat për energjinë. Një karakteristikë e kontratave të energjisë është që ato mund të kontabilizohen si instrumente financiare, qira apo si kontrata me klientë, në varësi të termave dhe kushteve të kontratës. Kjo ndodh si në rastin e standardeve aktuale që zbatohen dhe në rastin e standardeve të reja që do zbatohen. Shoqëria ka përfunduar procesin e identifikimit të kontratave të energjisë të cilat përfshihen në qëllimin e SNRF 9 ose SNRF 15.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përves rasteve kur shprehet ndryshe)

6. Standarde të reja të cilat nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

A. Efekti i vlerësuar i adoptimit të SNRF 15 dhe SNRF 9 (vazhdim)

Procesi i implementimit ka një qëllim global gjate të cilit janë në shqyrtim të gjitha kontratat materiale të energjisë. Bazuar në analizat e bëra deri më sot, Shoqëria nuk pret ndonjë efekt të rëndësishëm nga aplikimi i SNRF 15 dhe SNRF 9 në lidhje me njohjen dhe matjen.

Natyrë e ndryshimeve të pritshme për çdo standard është diskutuar më poshtë.

B. SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 krijon një model gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur njihen të ardhurat. Ai zëvendëson udhëzuesin ekzistues lidhur me njohjen e të ardhurave, përfshirë SNK 18 *Të ardhurat*, SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit* dhe KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientit*. SNRF 15 është efektive duke filluar nga ose pas 1 janarit 2018, me zbatim të hershëm të lejuar. Parimi kryesor sipas SNRF 15 është të njohë të ardhurën në një vlerë e cila reflekton shumën që entiteti pret të marrë në këmbim të transferimit të mallrave apo shërbimeve një klienti. Për të arritur këtë, SNRF 15 krijon një model me pesë hapa për të kontabilizuar të ardhurën që lind nga kontratat me klientët.

(i) Tregtia e energjisë

Për tregtinë e energjisë, aktualisht e ardhura njihet kur rreziqet dhe përfitimet specifike të pronësisë janë transferuar tek klienti, marrja e shumës së transferueshme është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të maten me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. E ardhura njihet me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për t'u marrë, neto nga kthimet.

Për shitjet e energjisë, aktualisht transferimi ndodh kur sasia aktuale e energjisë injektohet në rrjet dhe matet në pikën e dorëzimit. E ardhura nga shitjet ndërkufitare të energjisë nëpërmjet territorit shqiptar (Rrjetit të Transmetimit Shqiptar) njihet bazuar në kalendarin orar të konfirmuar nga palët.

Gjatë 2017, Shoqëria ka bërë një vlerësim paraprak të efekteve të SNRF 15 në të ardhurat nga kontratat e energjisë, siç u përmend më sipër dhe në të ardhurat nga kontratat e tjera brenda qëllimit të standardit, siç janë kontratat për shitjen e energjisë nëpërmjet shkëmbimit. Bazuar në informacionin e disponueshëm, Shoqëria nuk pret efekte të rëndësishme nga SNRF 15 në kuadër të njohjes dhe matjes së të ardhurës. Përfundimi paraprak mund të ndryshojë, për sa kohë analiza vazhdon ende.

(ii) Kryerja e shërbimeve

Gjatë vitit 2017, Shoqëria ishte përfshirë në ofrimin e shërbimeve të lidhura me kontratat e energjisë. Nëse shërbimet e përfshira në një kontratë ofroheshin në periudha raportuese të ndryshme, atëherë shuma e transferueshme shpërndahej në mënyrë relative në bazë të vlerës së drejtë midis shërbimeve të ndryshme. E ardhura njihet duke përdorur metodën e fazës së kompletimit.

Bazuar në informacionin e disponueshëm aktualisht, Shoqëria nuk pret që të ketë të ardhura nga shërbimet në periudhat e ardhshme. Kështu që, Shoqëria nuk pret që SNRF 15 të ketë ndikim material në njohjen dhe matjen e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve.

(iii) Tranzicioni

Bazuar në informacionin e disponueshëm, Shoqëria nuk pret që SNRF 15 të ketë ndikim material për sa i përket njohjes dhe matjes. Gjithashtu kërkohen shënime shpjeguese shtesë. Përfundimi paraprak mund të ndryshojë, për sa kohë analiza vazhdon ende.

6. Standarde të reja të cilat nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

C. SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9 Instrumentet Financiare përcakton kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontratave për blerjen apo shitjen e zërave jo-financiare. Ky standard zëvendëson SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*.

(i) Klasifikimi – Aktivet financiare

SNRF 9 përmban një qasje të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare e cila reflekton modelin e biznesit në të cilin administrohen aktivet dhe karakteristikat e tyre të flukseve të parasë.

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore për klasifikimin e aktiveve financiare: të matura me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese sipas SNK 39 të aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim, hua dhe të arkëtueshme dhe të gatshme për shitje.

Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë në kontrata ku objekti është një aktiv financiar sipas përkufizimit të standardit, nuk ndahen në asnjë rast. Ndërkohë, instrumenti financiar hibrid në tërësi vlerësohet për klasifikim.

Bazuar në vlerësimin e saj, Shoqëria nuk beson që kërkesat e reja për klasifikimin do kenë një efekt material në trajtimin kontabël të llogarive të arkëtueshme.

(ii) Zhvlerësimi – Aktivet financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të ndodhura” të SNK 39 me modelin progresiv “humbjet e pritshme të kredisë” (HPK). Kjo do të kërkojë gjykime të konsiderueshme për faktin se si ndryshimet në faktorët ekonomikë ndikojnë tek HPK-të, të cilat do përcaktohen mbi bazën e probabilitetit të ponderuar.

Modeli i ri i zhvlerësimit do të aplikohet tek aktivet financiare të matura me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, përveç investimeve në instrumente të kapitalit.

Sipas SNRF 9, humbjet do maten në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- *HPK 12 mujore*: këto janë HPK-të të cilat rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve nga data e raportimit; dhe
- *HPK përgjatë jetës*: këto janë HPK-të të cilat rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Matja e HPK-ve përgjatë jetës aplikohet nëse rreziku i kredisë i aktivitetit financiar në datën e raportimit është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare dhe në rast se jo, aplikohet matja e HPK-ve 12 mujore. Një entitet mund të përcaktojë që rreziku i kredisë së një aktiviteti financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme, nëse aktiviteti në datën e raportimit ka një rrezik të ulët të kredisë. Megjithatë, matja e HPK-ve përgjatë jetës aplikohet gjithmonë për llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk kanë një komponent të konsiderueshëm financimi.

Bazuar në vlerësimin e saj, Shoqëria nuk beson që kërkesat e reja për modelin e zhvlerësimit të aktiveve financiare, sipas qëllimit të SNRF 9, do kenë një efekt material në humbjet e saj nga zhvlerësimi.

(iii) Klasifikimi – Detyrimet financiare

SNRF 9 kryesisht ruan të njëjtat kërkesa si tek SNK 39 për klasifikimin e detyrimeve financiare.

Megjithatë, sipas SNK 39 të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë prezantohen kryesisht si më poshtë:

- shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë e cila i përket ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimeve, përfshihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse; dhe
- shuma e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë përfshihet në fitimin ose humbjen e periudhës.

Shoqëria nuk ka përcaktuar ndonjë detyrim financiar me vlere të drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe nuk ka qellim aktual në lidhje me këtë. Vlerësimi i Shoqërisë nuk tregon ndonjë ndikim të rëndësishëm në lidhje me klasifikimin e detyrimeve financiare më 1 janar 2018.

6. Standarde të reja të cilat nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

C. SNRF 9 Instrumentet Financiarë (vazhdim)

(iv) Shënimet shpjeguese

SNRF 9 kërkon shënime të reja shtesë, në veçanti për kontabilitetin mbrojtës, rrezikun e kredisë dhe HPK-të. Vlerësimi i Shoqërisë përfshinte një analizë për të identifikuar mungesat në të dhëna kundrejt proceseve aktuale dhe Shoqëria është në fazën e implementimit të sistemit dhe të ndryshimeve në procedurat e kontrollit, të cilat ajo beson që do jenë të nevojshme për të marre të dhënat e nevojshme.

(v) Tranzicioni

Në vijim të analizës së kryer për kontratat e energjisë, siç u përmend më sipër, Shoqëria ka kryer një vlerësim të përgjithshëm të aspekteve të tjera të SNRF 9. Vlerësimi është bazuar në informacionin e disponueshëm aktualisht dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve deri në datën e zbatimit. Në përgjithësi, Shoqëria nuk pret efekte të konsiderueshme nga SNRF 9 në kuadër të ndryshimeve në politikat kontabël, përveç shënimeve shpjeguese shtesë të nevojshme.

D. SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet aktuale në lidhje me qiratë duke përfshirë SNK 17 *Qiratë*, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një marrëveshje mund të klasifikohet si qira*, KIS 15 *Lehtësirat e qirasë operative* dhe KIS 27 *Vlerësimi thelbësor i transaksioneve të cilat përfshijnë formën ligjore të një qiraje*.

Standardi është efektiv duke filluar nga 1 janari i vitit 2019. Zbatimi i hershëm është i lejuar për ato shoqëri të cilat zbatojnë SNRF 15 para ose në datën e zbatimit të SNRF 16.

SNRF 16 prezanton një model të vetëm kontabël për paraqitjen e qirave në pasqyrën e pozicionit financiar. Qiramarrësi njeht një aktiv me të drejtë përdorimi i cili përfaqëson të drejtën e tij për të përdorur aktivin në fjalë dhe një detyrim për qira e cila përfaqëson detyrimin për të bërë pagesat e qirasë. Në standard ka përjashtime për njohjen e qirave afatshkurtra dhe qirave me vlerë të ulët. Kontabilizimi nga ana e qiradhënësit mbetet i ngjashëm me atë sipas standardit aktual – d.m.th. qiradhënësi vazhdon t'i klasifikojë qiratë si qira financiare ose qira të zakonshme.

Shoqëria ka përfunduar vlerësimin fillestar të efekteve të mundshme në pasqyrat e saj financiare, por nuk ka përfunduar ende vlerësimin e detajuar. Efekti aktual i aplikimit të SNRF 16 në pasqyrat financiare të periudhës kur ka nisur fillimisht zbatimi i standardit, do varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave të Shoqërisë në atë datë, vlerësimit final të Shoqërisë në lidhje me faktin nëse ajo do ushtrojë ndonjë opsion për rinovimin e qirave dhe nga masa në të cilën Shoqëria zgjedh që të përdorë vlerësimin praktike dhe përjashtimet në njohje.

Deri më tani, efekti më i rëndësishëm i identifikuar është që Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja në lidhje me qiratë e saj të zakonshme për zyrat. Më 31 dhjetor 2017, minimumi i pagesave të ardhshme kontraktuale për qiratë e zakonshme të Shoqërisë ishte në vlerën e paskontuar prej 5,860,297 lekësh.

Gjithashtu, natyra e shpenzimeve të lidhura me qiratë do ndryshojë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimin linear të qirasë operative me amortizimin e aktivitetit për të drejtën e përdorimit dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimin e qirasë.

Tranzicioni

Përgjatë tranzicionit drejt zbatimit të SNRF 16, Shoqëria mund të zgjedhë:

- të aplikojë përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16 për të gjitha kontratat e qirasë; ose
- të aplikojë vlerësimin në praktike dhe të mos shqyrtojë faktin nëse një kontratë është apo përmban një qira.

Shoqëria planifikon të zbatojë lehtësitë praktike për të përjashtuar përkufizimin e qirasë gjatë tranzicionit. Kjo do të thotë që Shoqëria do të zbatojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e qirasë të lidhura deri më 1 janar 2019 dhe që janë identifikuar si të tilla në përputhje me SNK 17 dhe KIRFN 4.

6. Standarde të reja të cilat nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

D. SNRF 16 Qiratë (vazhdim)

Si qiramarrës, shoqëria mund të zbatojë standardin duke përdorur:

- qasjen retrospektive; ose

- qasjen retrospektive të modifikuar me mundësinë e metodave praktike

Qiramarrësi e zbaton zgjedhjen në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha qiratë. Shoqëria planifikon të zbatojë fillimisht SNRF 16 më 1 janar 2019, duke përdorur qasjen retrospektive të modifikuar. Kështu që, efekti kumulativ i adoptimit të SNRF 16 do të njihet si një rregullim i balancës hapëse të fitimit të pashpërndarë më 1 janar 2019, pa kryer një rregullim të informacionit krahasues.

Në aplikimin e qasjes retrospektive të modifikuar për qiratë të cilat më përpara kanë qenë klasifikuar si qira të zakonshme sipas SNK 17, qiramarrësi mund të zgjedhë nëse dëshiron të aplikojë një numër të caktuar të lehtësive praktike përgjatë tranzicionit. Shoqëria po vlerëson efektin e mundshëm e përdorimit të këtyre metodave praktike .

Shoqëria nuk është e detyruar të bëjë ndonjë ndryshim në lidhje me qiratë në të cilat ajo është në rolin e qiradhënësit, përveç rasteve kur ajo është qiradhënëse e ndërmjetme në një kontratë nën-qiraje.

E. Standarde të tjera

Standardet e reja apo të ndryshuara nuk pritet të kenë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- **Ndryshime të SNRF 2: Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2018; Të aplikohet në periudhat e mëvonshme. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNRF 10 dhe SNK 28 Shitjet ose kontributet në aktive ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjeve të tij apo sipërmarrjeve të tij të përbashkëta.** (Data efektive nuk është përcaktuar ende nga BSNK, megjithatë zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNRF 4 Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar në ose mbas 1 janarit 2021, të aplikohet sipas metodës prospektive).
- **Ndryshime të SNK 40 Transferimi i Pronës së investuar** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar në ose mbas 1 janarit 2018, të aplikohet sipas metodës prospektive)
- **KIRFN 22 Transaksionet në monedhë të huaj dhe Shumat e paguara në Avancë.** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar në ose pas 1 janarit 2018).

7. Ndryshime të reja, të hyra në fuqi

Ka disa ndryshime të standardeve aktuale të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve dhe Raportimit Financiar Ndërkombëtar të cilat u bënë efektive gjatë periudhës aktuale.

- **Ndryshime të SNK 7** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose mbas 1 janarit 2017. Të aplikohet në periudhat e mëvonshme. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 12: Njohja e të drejtës nga tatimi i shtyrë për humbjet e parealizuara** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose mbas 1 janarit 2017. Të aplikohet në periudhat e mëvonshme . Zbatimi i hershëm është i lejuar.)

Adoptimi i këtyre interpretimeve dhe ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë ndryshime të politikave kontabël të Shoqërisë apo efekte të rëndësishme në pasqyrat financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

8. Prona, makineri dhe pajisje

Pronat, makineritë dhe pajisjet janë të përbëra si vijon:

<i>Kosto</i>	Objekte të rregullimit të ujit	Turbina, gjeneratorë	Ndërtesa, rrugë, ura, kalata	Përmirësime të ambienteve me qira	Mjete, pajisje dhe mjete transporti	Objektet e rrjetit	Aktive në proces	Totali
Më 1 janar 2016	-	-	-	61,516,978	539,746,311	-	37,620,399,739	38,221,663,028
Shtesa	-	-	-	15,406,083	42,644,553	-	17,090,930,229	17,148,980,865
Transferime ndërmjet klasave të aktiveve	11,367,889,099	6,504,711,107	6,718,942,865	-	2,259,026,744	-	(26,850,569,815)	-
Më 31 dhjetor 2016	11,367,889,099	6,504,711,107	6,718,942,865	76,923,061	2,841,417,608	-	27,860,760,153	55,370,643,893
Transferime ndërmjet klasave të aktiveve	1,800,038,307	917,097,755	(317,836,344)	-	(704,579,240)	210,105,656	(1,904,826,134)	-
Shtesa	-	-	-	-	3,268,320	-	10,587,374,911	10,590,643,231
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(3,414,247)	-	-	(3,414,247)
Më 31 dhjetor 2017	13,167,927,406	7,421,808,862	6,401,106,521	76,923,061	2,136,692,441	210,105,656	36,543,308,930	65,957,872,877
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Më 1 janar 2017	-	-	-	5,308,975	178,658,483	-	-	183,967,458
Amortizimi i vitit	17,941,981	27,407,653	10,932,675	3,234,149	94,435,073	-	-	153,951,531
Humbja nga zhvlerësimi	4,329,386,316	2,090,985,518	1,971,739,526	-	749,444,111	-	6,844,617,840	15,986,173,311
Më 31 dhjetor 2016	4,347,328,297	2,118,393,171	1,982,672,201	8,543,124	1,022,537,667	-	6,844,617,840	16,324,092,300
Transferime ndërmjet klasave të aktiveve	73,337,938	244,845,954	(17,638,232)	-	(310,132,689)	9,587,029	-	-
Amortizimi i vitit	150,195,562	183,884,358	59,960,018	3,418,993	157,649,540	4,023,783	-	559,132,254
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(2,282,841)	-	-	(2,282,841)
Më 31 dhjetor 2017	4,570,861,797	2,547,123,483	2,024,993,987	11,962,117	867,771,677	13,610,812	6,844,617,840	16,880,941,713
<i>Vlera kontabël neto</i>								
Më 1 janar 2016	-	-	-	56,208,003	361,087,828	-	37,620,399,739	38,037,695,570
Më 31 dhjetor 2016	7,020,560,802	4,386,317,936	4,736,270,664	68,379,937	1,818,879,941	-	21,016,142,313	39,046,551,593
Më 31 dhjetor 2017	8,597,065,609	4,874,685,379	4,376,112,534	64,960,944	1,268,920,764	196,494,844	29,698,691,090	49,076,931,164

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

8. Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)

(i) Humbja nga zhvlerësimi

Gjatë vitit 2017, drejtimi gjykoj se nuk ka patur tregues të zhvlerësimit të mëtejshëm të pronave, makinerive dhe pajisjeve si rezultat i testit të zhvlerësimit. Gjatë 2016, për shkak të rënies së pritshmërive në lidhje me të ardhurat nga shitja e energjisë, Shoqëria testoi për zhvlerësim hidrocentralin e Banjës dhe Moglicës duke i konsideruar si një njësi të vetme gjeneruese të parasë, për shkak se hidrocentralet ndodhen në të njëjtin burim ujor dhe administrohen së bashku për të optimizuar prodhimin e energjisë. Humbja nga zhvlerësimi prej 15,986,173,311 Lekë në lidhje me hidrocentralin e Banjës dhe Moglicës u njoh si më poshtë.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Hidrocentrali i Banjës	9,141,555,471
Aktivitet në proces të Moglicës	6,844,617,840
Totali	15,986,173,311

Humbja nga zhvlerësimi u njoh në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Gjatë 2016, vlera e rikuperueshme e njësisve gjeneruese të parasë (aktivitet e Banja dhe Moglica) u rivlerësuan duke përdorur vlerën aktuale neto të flukseve të ardhshme të cilat priten të merren nga këto njësi gjeneruese parash (vlera në përdorim). Norma e skontimit e përdorur ishte norma pas tatimit, e vlerësuar në bazë të mesatares historike të ponderuar të kostos së kapitalit të industrisë në një normë nominale vjetore të skontimit prej 7% dhe flukset monetare të pritura deri në fund të periudhës së koncesionit. Gjatë vitit 2017, kosto mesatare e ponderuar e kapitalit ishte 0.10% më e ulët se në 2016, që rezultoi në një vlerë prej 6.9%.

Flukset monetare të rëndësishme për qëllime të matjes u gjeneruan nga planifikimi aktual i Shoqërisë dhe çmimet e shitjeve u përcaktuan në bazë të parashikimit të çmimit të pritshëm të energjisë elektrike. Periudha e planifikimit përfshin afatin e parashikuar të përfundimit të koncesionit të hidrocentralit.

Vlerat e caktuara për supozimet kryesore përfaqësojnë vlerësimin e drejtimit për tendencat e ardhshme në industri dhe janë bazuar në të dhënat historike si nga burime të brendshme edhe të jashtme, dhe parashikimet e flukseve monetare të përfshira në vlerësimet për periudhën koncesionare. Bazuar në vlerësimin e vitit 2016, vlera e rikuperueshme u krahasua me vlerën kontabël të njësisve gjeneruese të parasë, e cila rezultoi të jetë 15,986,173,311 Lekë, më e vogël se vlera e tyre kontabël dhe si pasojë u njoh një humbje nga zhvlerësimi.

Më 31 dhjetor 2016 vlera e rikuperueshme e njësisve gjeneruese të parasë ishte si vijon:

	2016
Vlera e rikuperueshme	67,997 MLeK

Humbja nga zhvlerësimi është ndarë midis dy njësisve gjeneruese të parasë (aktivitet e Banja dhe Moglica) në mënyrë proporcionale sipas aktivitetit të pritur.

Vlerësimi për vlerat në përdorim janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve të ardhshme të çmimeve të energjisë dhe kostos së ponderuar të kapitalit. Një ndryshim i ardhshëm i çmimit të energjisë me +10% do të rezultojë në një rritje prej afërsisht 48 milion Euro. Një ndryshim në Koston Mesatare të Ponderuar të Kapitalit me +0.7% do të rezultojë në një rritje prej afërsisht 60 milion euro.

(ii) Garancitë

Asnjë prej zërave të pronave, makinerive dhe pajisjeve nuk është lënë kolateral më 31 dhjetor 2017.

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

8. Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)*(iii) Aktivet në proces*

Aktivitet në proces përfshijnë kostot e ndërtimit të hidrocentralit të Moglicës. Këto punime janë të lidhura ngushtë me zbatimin e projektit koncesionar të Devoll Hydropower dhe janë të domosdoshme për përfundimin e këtij projekti.

Ndërtimi i hidrocentralit të Banjës përfundoi gjatë 2016 dhe aktivet e tij u transferuan nga aktivet në proces në kategoritë përkatëse të aktiveve.

(iv) Amortizimi i kapitalizuar

Amortizimi i kapitalizuar i pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe amortizimi i aktiveve jo materiale që i përkasin aktiveve në proces janë në vlerën 39,698,637 Lekë në 2017 (2016: 68,010,751 Lekë).

Rakordimi mes shpenzimeve të amortizimit dhe amortizimit të kapitalizuar paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzimi i amortizimit dhe zhvlerësimit (shih shënimet 8, 9)	567,527,550	159,311,917
Amortizimi dhe zhvlerësimi i kapitalizuar	<u>(39,698,637)</u>	<u>(68,010,751)</u>
Amortizimi dhe zhvlerësimi i njohur si shpenzim	<u>527,828,913</u>	<u>91,301,166</u>

9. Aktivet jo materiale

Aktivitet jo materiale janë të përbëra si vijon:

	Programe kompjuterike	Aktive të tjera jo- materiale	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2016	29,410,583	11,635,391	41,045,974
Shtesa	-	4,918,986	4,918,986
Më 31 dhjetor 2016	<u>29,410,583</u>	<u>16,554,377</u>	<u>45,964,960</u>
Shtesa	34,460,915	478,351	34,939,266
Më 31 dhjetor 2017	<u>63,871,498</u>	<u>17,032,728</u>	<u>80,904,226</u>
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar, 2016	17,093,334	5,892,651	22,985,985
Amortizimi i vitit	3,079,313	2,281,073	5,360,386
Më 31 dhjetor 2016	<u>20,172,647</u>	<u>8,173,724</u>	<u>28,346,371</u>
Amortizimi i vitit	6,186,338	2,208,958	8,395,296
Më 31 dhjetor 2017	<u>26,358,985</u>	<u>10,382,682</u>	<u>36,741,667</u>
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2016	12,317,249	5,742,740	18,059,989
Më 31 dhjetor 2016	9,237,936	8,380,653	17,618,589
Më 31 dhjetor 2017	<u>37,512,513</u>	<u>6,650,046</u>	<u>44,162,559</u>

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

10. Parapagime

Parapagimet janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<i>Pjesa afatshkurtër</i>		
Parapagime për nën-kontraktorët	467,069,336	430,136,032
Qira e parapaguar si garanci	5,962,432	15,302,710
Garancitë financiare	3,731,617	3,701,617
Shpenzime të parapaguara	843,151	91,621,440
Paradhënie ndaj punonjësve	765,867	225,760
Tatim fitimi i parapaguar	105,033	105,033
Aktive të parapaguara	-	20,858,463
	468,477,436	561,951,055
<i>Pjesa afatgjatë</i>		
Parapagime për nën-kontraktorët	1,655,304,019	1,227,188,674
Shpenzime të parapaguara	-	39,492,189
	1,655,304,019	1,266,680,863
	2,123,781,455	1,828,631,918

Parapagimet afatshkurtra dhe afatgjata ndaj nën-kontraktorëve përfaqësojnë punimet civile në hidrocentralin e Banjës dhe Moglicës. Shpenzimet e parapaguara për vitin 2016 lidhen me primin e sigurimit të projektit të njohur në vitin aktual.

11. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
TVSH për t'u rimbursuar	204,094,761	-
Të arkëtueshme nga palët e lidhura (shih shënimin 28)	195,619,239	162,274,393
Të arkëtueshme nga palët e tjera	156,681,125	46,487,404
Të tjera të arkëtueshme	19,087,606	86,394,528
TVSH e zbritshme	-	207,776,978
Totali	575,482,731	502,933,303

TVSH për t'u rimbursuar përfaqëson shumën e TVSH-së për të cilën Shoqëria ka aplikuar dhe është miratuar për rimbursim.

Gjatë 2017, Shoqëria aplikoi për rimbursimin e TVSH-së së zbritshme të vitit 2016 dhe 2015, në shumën totale prej 206,145,774 Lekësh. Bazuar në kontrollin tatimor datë 24 nëntor 2017, autoritetet tatimore aprovuan shumën e TVSH-së së rimbursueshme në shumën totale prej 204,094,761 Lekësh për të dy vitet.

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura përfaqësojnë shumën e pagueshme nga shoqëritë e grupit për shitjen e energjisë dhe shërbimet e lidhura. Të arkëtueshmet nga palët e tjera përfaqëson shumën e pagueshme nga palët e tjera për shitjen e energjisë.

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

12. Garanci bankare

Garancia bankare më 31 dhjetor 2017 në shumën prej 13,600,000 Lekësh (2016: 10,000,000 Lekë) përfshin fonde të bllokuara në llogarinë bankare të Shoqërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj për Operatorin Shqiptar të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) në zbatim të Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike.

13. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Mjete monetare në arkë		
Arka (në Lek)	400,816	311,839
Arka (në EUR)	280,461	303,526
	681,277	615,365
Mjete monetare në bankë		
Llogaritë "Escrow" (në Lek)	19,922,302	16,932,744
Llogari rrjedhëse (në Lek)	35,029,932	33,997,420
Llogari rrjedhëse (në EUR)	3,231,353,797	6,880,101,379
Llogari rrjedhëse (në USD)	-	(128)
	3,286,306,031	6,931,031,415
Totali	3,286,987,308	6,931,646,780

Llogaritë "Escrow" janë hapur me qëllimin për të transferuar pagesat në favor të pronarëve të shpronësuar sipas Akt-Marrëveshjes ndërmjet METE (aktualisht MEI) dhe Devoll Hydropower Sh.A. Kjo marrëveshje kërkon që pronarët të kompensohen për shpronësimin e pronave të tyre nga MEI (fillimisht METE) në bashkëpunim me Devoll Hydropower Sh.A.

Depozita me afat më 31 dhjetor 2017 përfaqëson depozita njëditore ("overnight") me interes të barabartë me 0.1%.

14. Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar i emetuar paraqitet më poshtë:

	2017			2016		
	Numri i Aksioneve	Vlera Nominale	Totali i vlerës së aksioneve	Numri i Aksioneve	Vlera Nominale	Totali i vlerës së aksioneve
Më 1 janar	61,970	1,000,000	61,970,000,000	45,420	1,000,000	45,420,000,000
Kontribute nga aksionari	8,085	1,000,000	8,085,000,000	16,550	1,000,000	16,550,000,000
Më 31 dhjetor i paguar plotësisht	70,055	1,000,000	70,055,000,000	61,970	1,000,000	61,970,000,000

Statkraft Markets B.V është aksionari i vetëm i Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Aksionari i vetëm është mbajtësi i së drejtës për përfitimin e dividendëve të ardhshëm, nëse shpërndahen.

Kontributet e aksionarit të vetëm

Kontributet e kryera nga aksionari i vetëm gjatë vitit, përbëhen si më poshtë:

	19 maj 2017	13 shtator 2016	3 qershor 2016
Numri i aksioneve	8,085	8,252	8,298
Vlera nominale	1,000,000	1,000,000	1,000,000

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

15. Primi i kapitalit aksionar

Më 31 dhjetor 2017, primi i kapitalit të Shoqërisë është 8,590,000 Lekë.

16. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme ndaj palëve të tjera	750,201,790	1,130,166,670
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shih shënimin 28)	90,411,223	210,189,389
Shuma të mbajtura ndaj nën-kontraktorëve	1,079,998,618	1,038,369,370
Shpenzime të llogaritura	2,309,086,384	2,641,168,486
	4,229,698,015	5,019,893,915

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të tjera përfaqësojnë kryesisht shumatat për nën-kontraktorët në lidhje me punimet civile të kryera.

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë shumatat ndaj shoqërive të grupit në lidhje me blerjet e energjisë dhe shërbimeve të marra nga ata në përputhje me Marrëveshjen për Shërbime dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve.

Shuma të mbajtura nga nën-kontraktorët paraqesin paratë e mbajtura të përlllogaritura në bazë të vlerës së çdo certifikate të pagesave në lidhje me punimet civile të kryera nga nën-kontraktorët. Pagesa e shumës së mbajtur nga nën-kontraktorët do të kryhet sapo kushtet e specifikuar në kontratë në lidhje me certifikimin e punimeve të jenë plotësuar.

Shpenzimet e llogaritura përfshijnë shërbimet e kryera nga palët në vijim:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Statkraft AS	64,475,831	136,875,497
Statkraft Market	15,988,130	-
Statkraft Energy Ltd	3,091,248	-
Statkraft Enerji A.S.	941,286	41,368,473
	84,496,495	178,243,970
Të pagueshme ndaj palëve të tjera		
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	2,018,193,097	684,255,686
Shoqëritë Alstom	102,371,500	1,554,578,972
Alb-Star Sh.p.k	62,486,500	-
AF Consult Switzerland Ltd	11,806,899	54,478,440
Mott MacDonald & Tractebel	10,868,099	107,676,076
Sweco Norge AS	-	25,693,700
Multiconsult	-	21,636,800
Të tjera	18,863,794	14,604,842
	2,224,589,889	2,462,924,516
Totali	2,309,086,384	2,641,168,486

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

17. Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj punonjësve	36,709,522	36,998,344
Tatimi mbi të ardhurat personale	14,215,503	14,540,867
TVSH e pagueshme	13,955,737	-
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,404,217	5,496,090
Tatimi në burim	1,236,168	105,633
Detyrime të tjera	493,210	766,437
Totali	72,014,357	57,907,371

18. Të ardhurat

Të ardhurat përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shitje energjie	2,012,354,409	758,156,757
Shitja e kapaciteteve të transmetimit të energjisë	3,914,631	4,594,569
Kryerja e shërbimeve	-	15,883,536
Totali	2,016,269,040	778,634,862

Klienti kryesor

Të ardhurat nga Statkraft Markets GmbH përfaqësojnë afërsisht 1,148,452,105 Lekë (2016: 661,621,197 Lekë) të totalit të ardhurave të Shoqërisë.

19. Blerje energjie

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje energjie nga palët e lidhura	611,075,801	296,559,302
Blerje energjie nga palë të tjera	11,171,307	24,325,793
Totali	622,247,108	320,885,095

20. Blerje kapacitetesh

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje kapacitetesh nga palët e lidhura	89,306,316	27,221,950
Blerje kapacitetesh nga palët e tjera	4,213,907	6,083,359
Licenca dhe tarifa për tregtimin e energjisë	75,000	20,000
Totali	93,595,223	33,325,309

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

21. Shërbime

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shërbimet nga palët e lidhura	599,544,556	345,135,836
Konsulencë e jashtme	132,364,480	47,820,929
Sigurime	48,179,541	2,750,242
Qira	37,135,235	65,318,584
Të tjera	31,172,664	6,137,537
Udhëtime dhe akomodime	20,834,701	27,557,900
Telefon, internet, shërbime postare	7,619,203	7,405,833
Të tjera shërbime konsulence	5,080,950	769,559
Totali	881,931,330	502,896,420

Pjesa më e madhe e shërbimeve të kryera nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 përbëhen nga shërbimet e kryera nga Statkraft AS dhe Statkraft Energy AS sipas Marrëveshjes për Shërbime dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve në shumat respektivisht 495,348 mijë Lekë (2016: 287,147 mijë Lekë) dhe 104,196 mijë Lekë (2016: 57,988 mijë Lekë).

22. Kosto personeli

Kostot e personelit përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Paga	751,160,059	776,295,593
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	37,353,521	38,376,541
Të tjera	11,991,345	54,920,019
Kosto personeli të kapitalizuara	(620,016,848)	(731,496,446)
Totali	180,488,077	138,095,707

Kostot e kapitalizuara të personelit përfaqësojnë shpenzimet direkte të përfshira në koston e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria.

23. Shpenzime të tjera

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Karburant dhe mirëmbajtje makine	30,647,083	384,217
Shpenzime zyre	26,307,374	10,351,182
Shpenzime për mbështetjen e komunitetit	14,244,888	88,321,200
Mirëmbajtje e pajisjeve	7,036,226	2,224,722
Shpenzime të tjera	5,925,694	3,857,841
Shpenzime reklame	4,704,996	2,202,821
Komisione bankare	3,861,810	3,078,904
Gjoha dhe kamatëvonesa	2,178,251	4,254,080
Shpenzime përfaqësimi	1,225,985	18,262,188
Mirëmbajtje rrugësh	-	128,404
Totali	96,132,307	133,065,559

Shpenzimet për mbështetjen e komunitetit përfaqësojnë shpenzime të ndryshme të përballuara nga Shoqëria në mbështetje të grupeve të interesit që preken nga projekti i hidrocentraleve.

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

24. Humbja nga kurset e këmbimit, neto

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimet nga diferencat në kurset e këmbimit	210,077,508	204,240,490
Humbjet nga diferencat në kurset e këmbimit	(349,429,452)	(372,985,919)
Humbja nga kurset e këmbimit, neto	(139,351,944)	(168,745,429)

25. Të ardhura financiare, neto

E ardhura financiare përbëhet nga sa vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	10,541	1,666,440
Shpenzime për interesa	(52,731)	(2,826)
Të ardhura financiare, neto	(42,190)	1,663,614

26. Tatimi mbi fitimin**Tatimi mbi fitimin për periudhën**

Shoqëria nuk ka kryer ndonjë parapagim për tatimin mbi fitimin gjatë vitit 2017 dhe 2016. Përgjithësisht, tatimi mbi fitimin i parapaguar, nëse ka, mund të kompensohet nga shpenzimi për tatimin mbi fitimin, nëse ka.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbja për vitin	(525,348,052)	(16,594,189,520)
Shpenzime të pazbritshme	110,550,658	16,289,429,456
Amortizim shtesë për qëllime tatimore	(218,176,160)	-
Humbja tatimore për vitin	(632,973,554)	(304,760,064)
Tatimi mbi fitimin @ 15%	-	-
Humbja tatimore e mbartur	(632,973,554)	(304,760,064)

Më poshtë është paraqitur një rakordim i normës efektive të tatimit:

	2017	Norma efektive tatimore	2016	Norma efektive tatimore
Humbja për vitin	(525,348,052)		(16,594,189,520)	
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën tatimore të Shoqërisë	(78,802,208)	15%	(2,489,128,428)	15%
<i>Efekt i tatimit i:</i>				
Shpenzimeve të pazbritshme	16,582,599	(3.16%)	2,443,414,418	(14.72%)
Diferencat e përkohshme të zbritshme për të cilat nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra	(32,726,424)	6.23%		
Humbjet e vitit aktual për të cilat nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra	94,946,033	(18.07%)	45,714,010	(0.28%)
Totali i shpenzimit të tatimit mbi fitimin	-	-	-	-

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

26. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Shpenzimet e pazbritshme të 2017 lidhen kryesisht me shpenzimet e personelit dhe të përfaqësimit. Shpenzimet e pazbritshme të 2016 lidhen kryesisht me humbjen nga zhvlerësimi në vlerën 15,986,173,311 Lekë (shiko shënimin 10).

Aktive për tatime të shtyra

Më 31 dhjetor 2017 nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra për sa i përket zërave të mëposhtëm:

	2017		2016	
	Vlera bruto	Efekti tatimor	Vlera bruto	Efekti tatimor
Humbjet tatimore nga 2015	(447,030,427)	(67,054,564)	(447,030,427)	(67,054,564)
Humbjet tatimore nga 2016	(304,760,064)	(45,714,010)	(304,760,064)	(45,714,010)
Rivlerësimi nga kontrolli tatimor 2012 deri më 2016	461,113,656	69,167,048	-	-
Humbjet tatimore nga 2017	(414,797,394)	(62,219,609)	-	-
Totali i humbjeve tatimore	(705,474,229)	(105,821,135)	(751,790,491)	(112,768,574)
Diferencat e përkohshme të zbritshme	(8,887,016,616)	(1,333,052,492)	-	-
	(9,592,490,845)	(1,438,873,627)	(751,790,491)	(112,768,574)

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet.

Sipas legjislacionit tatimor aktual diferencat e zbritshme të përkohshme nuk skadojnë. Diferencat e zbritshme të përkohshme vijnë nga zëri i pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe lidhen me diferencën në kohë të njohjes së zhvlerësimit për qëllime tatimore. Zhvlerësimi i njohur si shpenzim i pazbritshëm në 2016, do të njihet për qëllime tatimore përgjatë jetës së dobishme të aktiveve nëpërmjet shpenzimit të amortizimit të llogaritur mbi vlerën e aktiveve pa përfshirë humbjen nga zhvlerësimi.

Më 31 dhjetor 2017 nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra në lidhje me këto zëra për shkak të pasigurive në lidhje më kohën se kur fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i mjaftueshëm për të përdorur përfitimet përkatëse.

Gjatë 2017, Shoqëria ka qenë subjekt i një kontrolli tatimor për qëllime të tatimit mbi fitimin. Bazuar në raport kontrollin përfundimtar datë 24 nëntor 2017, autoritetet tatimore rivlerësuan rezultatet tatimore të periudhave 2012 deri më 2016 duke zvogëluar humbjen tatimore respektive për këto vite. Efekti i rivlerësimit të humbjeve tatimore nga kontrolli në vlerën 461,113,656 Lekë është pasqyruar në vitin aktual.

27. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë mëmë dhe drejtuesit kryesorë. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet si më poshtë:

Të drejta nga palët e lidhura	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Statkraft Markets GmbH	189,770,239	162,274,393
Statkraft Energy AS	5,849,000	-
Totali (shih shënimin 11)	195,619,239	162,274,393
	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Shpenzime të përlllogaritura		
Statkraft AS	64,475,831	136,875,497
Statkraft Market	15,988,130	-
Statkraft Energy Ltd	3,091,248	-
Statkraft Enerji AS	941,286	41,368,473
Totali (shih shënimin 16)	84,496,495	178,243,970

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

27. Palët e lidhura (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj palëve të lidhura		
Statkraft AS	8,938,678	145,205,525
Statkraft Markets GmbH	32,063,293	47,272,714
Statkraft Energi AS	1,282,123	17,711,150
Statkraft Energy Ltd	1,554,393	-
Statkraft Enerji A.S.	46,063,332	-
Himal Power	509,404	-
Totali (shih shënimin 16)	90,411,223	210,189,389
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Transaksione me palë të lidhura		
Kapitalizuar si aktive në proces	268,342,411	580,374,111
Statkraft AS	237,445,715	533,393,658
Statkraft Enerji A.S.	29,901,027	20,892,657
Statkraft Energi AS	660,246	26,087,796
Statkraft India Pvt. Ltd.	335,423	-
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat	1,148,452,105	667,796,705
Statkraft Markets GmbH	1,148,452,105	661,621,197
Statkraft Western Balkans	-	6,175,508
Shpenzim në pasqyrën të ardhura dhe shpenzime	1,496,802,417	672,978,338
Statkraft Markets GmbH	871,746,592	239,571,679
Statkraft AS	513,410,929	229,802,995
Statkraft Enerji A.S.	58,693,406	19,668,331
Statkraft Energi AS	44,868,080	26,674,040
Statkraft Energy Ltd	6,303,760	-
Statkraft Western Balkans	-	151,614,077
Kompensimi i drejtuesve kryesorë	1,779,650	5,647,216

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Statkraft Markets B.V dhe shoqëria mëmë dhe filialet e saj janë e vetmja palë e lidhur. Pala kontrolluese përfundimtare e Shoqërisë është Statkraft A.S. Të gjitha balancat e papaguara ndaj palëve të lidhura janë çmuar duke u bazuar në parimin e tregut dhe duhet të paguhet brenda tre muajve nga data e raportimit. Asnjë prej shumave nuk është e siguruar. Nuk është marrë ose dhënë asnjë garanci.

28. Instrumentet financiare**(a) Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptuara nga Shoqëria që kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktive dhe detyrime financiare dhe për ato jo-financiare. Ku është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta është përfshirë në shënime të veçanta lidhur me aktivin ose detyrimin.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme vlerësohet të jetë e përafërt me vlerën e mbartur për shkak të natyrës së tyre afat-shkurtër.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

28. Instrumentet financiare (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare.

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

(i) *Kuadri i administrimit të rrezikut*

Bordi i drejtorëve të shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saja të trajnimit dhe drejtimit synon të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre.

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

(ii) *Rreziku i kreditit*

Rreziku i kreditit është rreziku i një humbje financiare nga Shoqëria në rast se një klient apo një palë në një instrument financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe krijohet kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme të Shoqërisë.

Shuma e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit.

Llogaritë e arkëtueshme

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është influencuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, drejtimi merr në konsideratë faktorët që mund të influencojnë rrezikun e kreditit të tyre si konsumatorë, duke përfshirë rrezikun e falimentimit të shoqëruar me rrezikun e industrisë dhe vendit në të cilin veprojnë klientët. Detajet e përqendrimit të ardhurave janë përfshirë në Shënimin 19. Kufizimet për kontratat e energjisë, janë përcaktuar për palën individuale duke përdorur një vlerësim të brendshëm të kreditit. Palët janë ndarë sipas kategorive të ndryshme. Vlerësimi i brendshëm i kreditit është bazuar në të dhënat financiare të rëndësishme (modeli i vlerësimit kryer nga Shoqëria/opinionin i ekspertit), vlerësimet e jashtme dhe probabilitetet e përcaktuara të blera nga ofruesit e jashtëm. Kontratat dypalëshe janë subjekt i kufizimeve për çdo palë tjetër për sa i përket vëllimit, sasisë dhe kohëzgjatjes. Rreziku për palën tjetër nga këto kontrata konsiderohet të jetë shumë i ulët.

Kufijtë e ekspozimit individual të çdo pale tjetër monitorohen vazhdimisht dhe i raportohen rregullisht drejtimit. Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditit nga llogaritë e arkëtueshme tregtare, duke vendosur një periudhë maksimale të pagesës nga një deri në tre muaj respektivisht për palët e lidhura dhe klientët e palëve të tjera. Kufijtë e kreditit mund të ulen duke pranuar mbështetjen e kreditit në formën e një garancie nga Shoqëria mëmë dhe/ose garanci bankare.

Shoqëria krijon një provigjion për zhvlerësim që përfaqëson vlerësimin e humbjeve të shkaktuara në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera. Më 31 dhjetor 2017, ekspozimi maksimal i llogarive të arkëtueshme ndaj rrezikut të kreditit sipas rajoneve gjeografike, paraqitet si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Gjermani	182,968,105	162,274,393
Shqipëri	156,681,125	46,487,404
Norvegji	5,880,372	-
	<u>345,529,602</u>	<u>208,761,797</u>

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

28. Instrumentet financiarë (vazhdim)**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(ii) Rreziku i kreditit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2017 ekspozimi maksimal i llogarive të arkëtueshme ndaj rrezikut të kreditit sipas palëve paraqitet si vijon:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Palët e lidhura	188,848,477	162,274,393
Palët e tjera	156,681,125	46,487,404
	345,529,602	208,761,797

Më 31 dhjetor 2017 klienti më i rëndësishëm i Shoqërisë, Statkraft Markets GmbH përbën 53% të vlerës së mbartur të llogarive të arkëtueshme (2016: Statkraft Markets, 78%).

Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta është llogaritur në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në lidhje me arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Nuk ekziston asnjë tregues për zhvlerësim në klasat e tjera të aktiveve financiare në datën e raportimit. Drejtimi i Shoqërisë beson se nuk ka asnjë tregues për zhvlerësimin e TVSH-së së arkëtueshme, bazuar në vlerësimin e shume faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojën e mëparshme.

Më 31 dhjetor 2017, vjetërsia e llogarive të arkëtueshme të cilat nuk janë zhvlerësuar paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017		Më 31 dhjetor 2016	
	Bruto	Zhvlerësimi	Bruto	Zhvlerësimi
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	345,529,602	-	208,761,797	-
Total	345,529,602	-	208,761,797	-

Të gjithë klientët kanë një marrëdhënie tregtare me Shoqërinë, për më pak se dy vjet.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen në bankë dhe institucione financiare të cilat janë të klasifikuara si Baa1 deri në Baa3, bazuar në vlerësimet e Moody's.

(iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo të ndonjë aktivi tjetër financiar. Qëllimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në vështirësi, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Shoqëria synon që të sigurojë mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj brenda 6 muajve të ardhshëm. Më poshtë janë paraqitur afatet kontraktuale të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Shumat janë bruto dhe të pa-aktualizuara.

31 dhjetor 2017	Vlera kontabël (neto)	Flukset kontraktuale të parasë			
		Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vite
Llogari të pagueshme	4,229,698,015	3,149,699,397	1,079,998,618	-	-
Të tjera të pagueshme	72,014,357	72,014,357	-	-	-
Totali	4,301,712,372	3,221,713,754	1,079,998,618	-	-

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

28. Instrumentet financiarë (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2016	Vlera kontabël (neto)	Flukset kontraktuale			
		Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vite
Llogari të pagueshme	5,019,893,915	3,981,524,545	1,038,369,370	-	-
Të tjera të pagueshme	57,907,371	57,907,371	-	-	-
Totali	5,077,801,286	4,039,431,916	1,038,369,370	-	-

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, të tilla si çmimi i energjisë elektrike, normat e interesit, normat e këmbimit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare të zotëruara. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm duke maksimizuar kthimin.

Rreziku i çmimit të tregut

Si një prodhues energjie, Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të tregut të lidhur me çmimin e energjisë. Brenda tregtimit të energjisë, shoqëria zotëron portofole që reduktojnë rrezikun e tregut, si dhe portofolet brenda rregullave të vendosura, ku Shoqëria pranon një shkallë të rrezikut të tregut në mënyrë që të gjenerojnë fitim. Administrimi i rrezikut në tregtimin e energjisë fokusohet në totalin e portofoleve dhe jo kontratave individuale. Udhëzimet e brendshme që kontrollojnë nivelin e ekspozimit të tregut janë krijuar për të gjitha portofolet. Rregulloret për tregtimin sipas të dy kontratave, fizike apo financiare, monitorohen vazhdimisht.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me ndryshimet e mundshme në normat e kurseve të këmbimit për sa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro si detyrim ndaj furnitorëve të saj, gjë që ekspozon Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre që maturohen në të njëjtën periudhë në të cilën detyrimet tregtare duhet të shlyhen.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 ishte si vijon:

Më 31 dhjetor 2017	Vlera kontabël	Euro (konvertuar në Lek)	Të tjera (konvertuar në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,286,987,308	3,231,634,258	-	55,353,050
Garanci bankare	13,600,000	-	-	13,600,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	575,482,731	360,129,692	-	215,353,039
Llogari të pagueshme	(4,229,698,015)	(2,998,629,580)	(118,742,905)	(1,112,325,530)
Të tjera të pagueshme	(72,014,357)	-	-	(72,014,357)
Ekspozimi neto	(425,642,333)	593,134,370	(118,742,905)	(900,033,798)

Devoll Hydropower Sh.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

28. Instrumentet financiarë (vazhdim)**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2016	Vlera kontabël	Euro (konvertuar në Lek)	Të tjera (konvertuar në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	6,931,646,780	6,880,404,904	(128)	51,242,004
Garanci bankare	10,000,000	-	-	10,000,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	295,156,325	271,303,459	-	23,852,866
Llogari të pagueshme	(5,019,893,915)	(4,871,795,813)	(113,532,417)	(34,565,685)
Të tjera të pagueshme	(57,907,371)	-	-	(57,907,371)
Ekspozimi neto	2,159,001,819	2,279,912,550	(113,532,545)	(7,378,186)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Gjatë vitit janë aplikuar normat e mëposhtme të kursit të këmbimit:

	Norma mesatare		Norma në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
Lek/EUR	134.12	137.31	132.95	135.23

Analiza e ndjeshmërisë ndaj kursit të këmbimit

Në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë.

Analiza e ndjeshmërisë së mëposhtme është zhvilluar duke u bazuar në ekspozimin ndaj kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimit të përcaktuar i cili ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë paraqitet analiza e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimin apo humbjen dhe kapitalit neto mbas tatimit, duke supozuar se të gjithë faktorët e tjerë në veçanti normat e interesit, janë konstante:

	2017	2016
EUR zhvlerësohet me 10%	(59,313,437)	(227,991,255)
EUR vlerësohet me 10%	59,313,437	227,991,255

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me ndonjë rrezik të rëndësishëm të normave të interesit të flukseve monetare sepse ajo nuk disponon detyrime financiare të cilat gjenerojnë interesa.

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

28. Instrumentet financiarë (vazhdim)**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse.

Shoqëria nuk ka ndonjë aktiv financiar dhe detyrim financiar me normë fikse të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe Shoqëria nuk cakton derivatet (këmbime të normës së interesit) si instrumente mbrojtëse sipas modelit të kontabilitetit mbrojtës me vlerë të drejtë. Prandaj, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimin ose humbjen.

(v) Administrimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të ruajë një bazë të fortë kapitali, me qëllim që të ruajë besueshmërinë e investitorëve, kreditorëve dhe të tregut dhe të ruajë zhvillimet e ardhshme të biznesit. Nuk ka patur ndryshime në metodën e Shoqërisë në lidhje me administrimin e kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme mbikëqyrëse në lidhje me kapitalin.

29. Angazhime dhe detyrime të ardhshme**Angazhime për qiranë operative**

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte lidhur 24 (2016: 27) kontrata qiraje të zakonshme në lidhje me qiranë e zyra në Tiranë dhe magazinave në Gramsh, hapësira parkimi dhe apartamente. Pagesat e ardhshme minimale të qirasë në bazë të kontratave janë si vijon:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Brenda një viti	15,049,488	23,405,207
Mbas një viti, por jo më shumë se 5 vite	-	-
	<u>15,049,488</u>	<u>23,405,207</u>

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë për zyrën në Tiranë dhe apartamentet në Tiranë dhe Gramsh për vitet që mbarojnë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, ishin përkatësisht 37,135,235 Lekë dhe 65,218,065 Lekë dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë në Tiranë dhe Gramsh për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 ishin 24,366,784 Lekë (2016: 25,923,470 Lekë) dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të pozicionit financiar.

Garancia e Kontratës

Duke iu referuar pikës 7.3.14 të Marrëveshjes Koncesionare, Koncesionari i ka paraqitur Autoritetit Kontraktues "METE" (aktualisht MEI) një Garanci Kontrate.

Garancia e Kontratës me vlerë fillestare 50 milion Euro i është dhënë Autoritetit Kontraktues në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në çdo rinovimi të mëpasshëm të garancisë së kontratës çdo vit, siç përshkruhet në Nenin 7.3.14 (b) të Marrëveshjes së Koncesionit.

Autoriteti Kontraktues bie dakord se shuma fillestare e Kontratës së Sigurisë do të reduktohet me:

- (i) 16 milion Euro pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës)
- (ii) 28 milion Euro pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Moglicës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Moglicës)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë Garancinë e Kontratës për çdo dëm të likuidimit sipas pikës 7.3.11 (a) të Marrëveshjes së Koncesionit, nëse Koncesionari dështon të paguajë shumën e tillë brenda afateve të specifikuar në seksionin 7.2.5 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Devoll Hydropower Sh.A.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe

29. Angazhime dhe detyrime të ardhshme (vazhdim)

Nga data efektive e Shtojcës së 3-të, Koncesionari ka ofruar një garanci kontrate për Autoritetin Kontraktues në vlerën prej 44 milion Euro dhe për çdo rinovim të mëtejshëm të garancisë së kontratës, e cila do të jetë e vlefshme për një periudhë minimale prej një viti.

Me datë efektive 1 shkurt 2018 garancia është 28 milion Euro pasi është marrë dhe certifikata përfundimtare e kompletimit të hidrocentralit të Banjës.

Angazhimet për kapitalin sipas Marrëveshjes Koncesionare

Bazuar në Marrëveshjen Koncesionare të nënshkruar midis Koncesionarit dhe METE (aktualisht MEI), koncesionari është përgjegjës për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll.

Angazhimet për kapitalin që rrjedhin nga shpronësimet e pasurive të paluajtshme

Nga viti 2012, Këshilli i Ministrave vendosi për shpronësimin e disa pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll.

Pronat që janë subjekt i shpronësimit do të kalojnë në favor të autoriteteve respektive si Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (METE - aktualisht MEI), Autoriteti Shqiptar i Rrugëve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të cilët më pas do t'i transferojnë Shoqërisë të drejtën e përdorimit të pronave.

Angazhimet në vlerën prej 80,996,408 Lekë lidhur me shpronësimet janë detyrime për t'u shlyer në të ardhmen.

Detyrime të kushtëzuara dhe procedura ligjore që rrjedhin nga kontrolli tatimor

Shoqëria ka qenë subjekt i një kontrolli tatimor për TVSH gjatë vitit 2012 dhe 2013. Bazuar në raportin e kontrollit tatimor datë 22 dhjetor 2011 dhe raportit të ri-kontrollit tatimor datë 8 gusht 2012, autoritetet tatimore vlerësuan gjoba për TVSH-në në vlerën 91,116,619 Lekë. Nga kjo shumë, 62,473,349 Lekë janë falur nga autoritetet tatimore bazuar në ligjin nr. 33 datë 30.03.2017 për faljen e disa detyrimeve dhe gjobave tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur ndonjë provigjion në pasqyrat financiare për shumën e mbetur prej 28,643,270 Lekësh të cilat aktualisht janë në proces gjyqësor. Bazuar në këshillimin ligjor të marrë, drejtimi beson në një rezultat të suksesshëm të procesit gjyqësor.

Gjithashtu, bazuar në raportin e kontrollit tatimor datë 9 prill 2013 dhe raportit të apelimit tatimor datë 9 gusht 2013, autoritetet tatimore kanë vlerësuar gjoba për TVSH-në në vlerën 16,243,181 Lekë. Shoqëria e ka dërguar çështjen në gjykatë dhe nuk ka njohur ndonjë provigjion në këto pasqyra financiare sepse drejtimi beson në një rezultat të suksesshëm bazuar në këshillimin ligjor.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procedure tjetër ligjore, ankimimi ose çështje gjyqësore gjatë rrjedhës normale të biznesit

30. Ngjarje mbas datës së raportimit financiar

Më 1 mars 2018 Tima Iyer Utne është zëvendësuar me Dag Hjort (shiko shënimin 1).

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat nevojiten rregullime apo shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare